

LETËR E HAPUR IMIGRANTËVE NË NEW YORK

Mos u druani të shkoni te mjeku, në klinikë, në spital ose në sallën e urgjencave. Imigrantët pa dokumente mund të marrin ndihmë mjekësore në New York pa problem.

Korporata e Shëndetësisë dhe e Spitaleve Health and Hospitals Corporation (HHC) administron spitalet publike në New York City. Ne ju respektojmë dhe duam t'ju ndihmojmë. Askush nga punonjësit e një spitali publik nuk do të njoftojë Shërbimin e Imigrimit, policinë ose ndonjë agjenci tjetër për statusin tuaj të imigrantit. Nuk do t'i themi njeriu. Spitalet publike dhe qendrat tona shëndetësore kanë traditë të vjetër e të nderuar të përkujdesjes për këdo që ka nevojë. Kjo përfshin imigrantët që nuk janë nënshtrës ose banorë të ligjshëm, si dhe ata që nuk kanë para të paguajnë për ndihmën mjekësore. Përkushtimi ynë është i plotë. Nuk ka ndryshuar.

Ja çfarë u premtojmë të gjithë imigrantëve pa dokumente:

HHC DO TË RESPEKTOJË TË DREJTËN TUAJ PËR FSHEHTËSI. DO TA MBAJMË TË FSHEHTË INFORMACIONIN PËR STATUSIN TUAJ TË IMIGRANTIT.

Është e drejta juaj të merrni ndihmë mjekësore cilësore. Mos e lini frikën t'ju pengojë që juve ose fëmijëve tuaj t'ju jepet ndihma mjekësore që ju nevojitet. Spitalet publike, qendrat shëndetësore dhe klinikat tona gjenden në të gjitha lagjet e New York-ut. Mjekët tanë, infermieret dhe punonjësit tanë të tjerë të shëndetësisë do të kujdesen për ju. Ata flasin shumë gjuhë. Shumë prej tyre janë vetë imigrantë ose fëmijë imigrantësh. Dëshira e tyre është t'ju shërbejnë me respekt. Të gjithë janë të vendosur t'ju ruajnë fshehtësinë. Shumica e fëmijëve dhe e grave shtatzëna mund të përfitojnë sigurim shëndetësor. Ky mund t'ju takojë madje edhe nëse nuk jeni imigrant i ligjshëm. Personeli i HHC mund t'ju ndihmojë të gjeni atë lloj sigurimi shëndetësor që ju nevojitet. Nëse nuk keni sigurim shëndetësor dhe nuk paguani dot shumë për ndihmën mjekësore, HHC do t'ju ndihmojë prapëseprapë. Çfarë do të paguani bazohet në sa para keni dhe sa pjesëtarë keni në familje. Punonjësit në një spital ose klinikë publike do t'ju kërkojnë disa të dhëna, për të përcaktuar sa duhet të paguani tamam. Do t'ju kërkojnë të provoni edhe se sa fitoni. Do t'ju duhet të paraqitni dokumente që tregojnë adresën tuaj të shtëpisë dhe ndonjë provë të identitetit tuaj, si dhe datën e lindjes. Të gjitha këto informacione do t'i mbajmë sekret. Do ta ruajmë fshehtësinë e tyre me fanatizëm.

Politika jonë është e qartë si drita e diellit. Asnjë punonjës i HHC nuk mund t'ia japë ASKIJT tjetër informacionin tuaj si pacient. Të gjithë punonjësit tanë e dinë se po të mos e mbajnë këtë zotim, mund të humbasin vendin e punës. E kuptojmë se vetëm në këtë mënyrë mund ta fitojmë dhe ta ruajmë mirëbesimin tuaj. E dimë edhe se mirëbesimi juaj na duhet, në mënyrë që t'ju sigurojmë ju dhe familjes suaj shërbime shëndetësore cilësore,

Merrni në telefon numrin 311 ose vizitoni faqen www.nyc.gov/hhc në Internet për të parë një listë të të gjitha spitaleve dhe qendrave shëndetësore HHC, ose për t'i dërguar një mesazh Presidentit të HHC, Alan Aviles, ose Komisioneres Bashkiake për Çështje të Imigracionit, Fatima Shama.

Alan D. Aviles, President
New York City Health and Hospital Corporation

Fatima Shama, Komisionere
Mayor's Office of Immigrant Affairs

Bronx

Jacobi Medical Center

1400 Pelham Parkway South
Bronx, New York 10461
718-918-5000

Lincoln Medical & Mental Health Center

234 East 149th Street
Bronx, New York 10451
718-579-5000

Morrisania Diagnostic & Treatment Center

1228 Gerard Avenue
Bronx, New York 10452
718-960-2777

North Central Bronx Hospital

3424 Kossuth Avenue
Bronx, New York 10467
718-519-5000

Segundo Ruiz Belvis Diagnostic & Treatment Center

545 East 142nd Street
Bronx, New York 10454
718-579-4000

Brooklyn

Coney Island Hospital

2601 Ocean Parkway
Brooklyn, New York 11235
718-616-3000

Cumberland Diagnostic & Treatment Center

100 North Portland Avenue
Brooklyn, New York 11205
718-260-7500

Dr. Susan Smith McKinney Nursing & Rehabilitation Center

594 Albany Avenue
Brooklyn, New York 11203
718-245-7000

East New York Diagnostic & Treatment Center

2094 Pitkin Avenue
Brooklyn, New York 11207
718-240-0400

Kings County Hospital Center

451 Clarkson Avenue
Brooklyn, New York 11203
718-245-3131

Woodhull Medical & Mental Health Center

760 Broadway
Brooklyn, New York 11206
718-963-8000

Manhattan

Bellevue Hospital Center

462 First Avenue
New York, New York 10016
212-562-4141

Coler Goldwater Specialty Hospital

Roosevelt Island
New York, New York 10044
212-848-6000

Gouverneur Healthcare Services

227 Madison Street
New York, New York 10002
212-238-7000

Harlem Hospital Center

506 Lenox Avenue
New York, New York 10037
212-939-1000

Metropolitan Hospital Center

1901 First Avenue
New York, New York 10029
212-423-6262

Renaissance Health Care Network Diagnostic & Treatment Center

215 West 125th Street
New York, New York 10027
212-932-6500

Queens

Elmhurst Hospital Center

79-01 Broadway
Elmhurst, New York 11373
718-334-4000

Queens Hospital Center

82-70 164th Street
Jamaica, New York 11432
718-883-3000

Staten Island

Mariner's Harbor Family Health Center

Forest Plaza Shopping Center
2040 Forest Ave
Staten Island, NY 10303
718-761-2060

Sea View Hospital Rehabilitation Center & Home

460 Brielle Avenue
Staten Island, New York 10314
718-317-3000

Stapelton Family Health Center

Tappan Park
111 Canal Street
Staten Island, NY 10304
718-390-0712

